



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2022:209209

Datë: 24.03.2024

Numri i dokumentit: 05494752

**P.nr.2595/22**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË** - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, në lëndën penale të akuzuarve Sh. K. dhe A. K. nga F. K., të akuzuar për veprën penale të kryer në bashkëkryerjeje Vjedhje neni 313 par 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.4223/22 të datë 12.10.2022, në seancën e shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 11.03.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Blerim Igrishta dhe të akuzuarve Sh. K. dhe A. K., me datë 12.03.2024 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 23.03.2024 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. Sh. K. nga i ati K., nëna B. e gjinisë J. i lindur me datë ..... në F. K., me vendbanim Lagjen nr... rrugën “Gj...”, me numër personal ..... të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, nuk ka të kryer shkollën, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Ashkali Shtetas e Republikës së Kosovës.
2. A. K. nga i ati K., nëna B.e gjinisë J. i lindur me datë ..... në F. K., me vendbanim Lagjen nr... rrugën “Gj...”, me numër personal ..... të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, nuk ka të kryer shkollën, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Ashkali Shtetas e Republikës së Kosovës.

### JANË FAJTORË

Sepse:

Me datën 31.07.2022 rreth orës 14:10 në F. K. në rrugën “H. Z.” pikërisht në lokalin afarist “Kam Market”, duke vepruar në bashkëkryerje me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete ia kanë marr/vjedh të dëmtuarit A. Th. pasurinë e tij/sendet të luajtshme të ndryshme në atë mënyrë që: hyjnë në Marketin e lartcekur dhe nga raftet marrin produkte ushqimore si mish dhe proshutë dhe largohen nga vendi i ngjarjes me veturën e markës WV T... ngjyrë hiri me targa ...-...-, duke i shkaktuar dëm të dëmtuarit në shumën prej 70 Euro.

- Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vjedhje neni 313 par 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 31, 38, 39, 42, 43, 70, 71, 72 dhe 313 par 1 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarit i:

## **GJYKON**

### **1. Të akuzuarin Sh. K.**

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi dhe

Me dënim me gjobë në shumë prej 300.00 (treqind) Euro, të cilin dënim i pandehuri obligohet që ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar më lartë, atëherë gjykata këtë dënim do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, duke llogaritur një ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj paushallin gjyqësor në shumë shumën prej 20 (njëzet) Euro si dhe shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

### **1. Të akuzuarin A. K.**

Me dënim me burgim kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi dhe

Me dënim me gjobë në shumë prej 300.00 (treqind) Euro, të cilin dënim i pandehuri obligohet që ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar më lartë, atëherë gjykata këtë dënim do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, duke llogaritur një ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj paushallin gjyqësor në shumë shumën prej 20 (njëzet) Euro si dhe shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Gjykata, në këtë çështje penale juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 11.03.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Blerim Igrishta, të pandehurve Sh.dhe A. K. ku të njëjtit u njoftuan me të drejtat e tyre, me aktakuzën dhe provat kundër tyre. Pas kësaj prokurori i shtetit lexoj aktakuzën kundër të pandehurve.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori të pandehurit u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës.

Pas deklarimit të pandehurve dhe mendimit të prokurorit se nuk e kundërshtojë pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se të pandehurit kanë pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, të pandehurit janë të vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarve se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurve Sh. dhe A. K. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Vjedhje nga neni 313 par 1 i KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të tyre, kështu që të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarit, gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarin Sh. K. Gjykata mori për bazë të kaluarën e tij kriminale nga ku rezultoi se i pandehuri është i dënuar për një numër të madh të veprave penale kryesisht të natyrës së njëjte por edhe për lloje të tjera të veprave sipas aktgjykimeve të formës së prere: P.nr.783/2021, P.nr.512/20214, P.nr.264/2016, P.nr.133/2017, P.nr.4504/2019, P.nr.864/2019, P.nr.524/2020, P.nr.240/2020, P.nr.771/2019, P.nr.49/2020, P.nr.874/2022, P.nr.876/2022 etj. Ndërsa për të pandehurin A. K. Gjykata mori për bazë të kaluarën e tij kriminale nga ku rezultoi se edhe ky është i dënuar për një numër të madh të veprave penale kryesisht të natyrës së njëjte por edhe për lloje të tjera të veprave sipas aktgjykimeve të formës së prere si: P.nr.2961/16, P.nr.1613/15, P.nr.3070/15, P.nr.5511/17, P.nr.186/17, P.nr.72/2016, P.nr.133/2017, P.nr.4580/19, P.nr.2659/19, P.nr.772/20, P.nr. 2455/20, P.nr.3395/21, P.nr.1912/20 etj.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata në kuptim të nenit 42 dhe 43 të KPRK-se të akuzuarit i gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarve është në përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen veçanërisht llojin e njëjte të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 te KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 €uro për secilin të pandehur.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL  
P.nr.2595/22 datë 23.03.2024**

**Gjyqtarja e vetme Gjykuese**

---

**Laura Hoti Statovci**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.